



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

AD.GJTHM.nr.11/23

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – U.D Kryetari i Gjykatës Bekim Veliqi, duke vendosur në çështjen disiplinore të ngritur ndaj J.Z, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga pala A.Ll nga Komuna e Vushtrrisë, pas vlerësimit të kërkesës-ankesës së parashtruar nga pala A.Ll dhe pranimit të deklaratës së Gjyqtarit J.Z, në vlerësim të shkresave të lëndës, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuror dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 23.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR Ankesa disiplinore e dt.06.11.2023, e regjistruar me numër të lëndës AD.GJTHM.nr.11/2023, e parashtruar nga pala A.Ll me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë rr.“...” nr., kundër Gjyqtarit J.Z Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Në cilësinë e U.D Kryetarit të Gjykatës Themelore Mitrovicë me dt.06.11.2023, kam pranuar ankesën nga pala A.Ll me vendbanim në Vushtri rr.“...” nr., ndaj Gjyqtarit J.Z, Gjyqtar në Gjykatës Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

Pala A.Ll në ankesë cekë shqetësimet e tij lidhur me zvarritjen e lëndës CN.nr.77/22 që ka të bëjë me kompensimin e palujtshëmrisë së shpronësuar, e cila është në procedurës gjyqësore tash e 33 vjet dhe deri më tani nuk kanë pranuar ftesë nga Gjykata në fjalë, kërkoj një përgjigje pse lënda e tij familjare nuk është trajtuar një kohë të gjatë, pasi që edhe ai ka obligim moral dhe familjar për t'u përgjigjur të gjithë trashigimtarëve arsyjen e ngecjes së procedimit të kësaj lënde.

Autoriteti kompetent në rastin konkret ka marrë veprime procedurale pas pranimit të ankesës, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj subjektit të hetimit-gjyqtarit, i cili ka dhënë deklaratë me shkrim lidhur me ankesën e palës i cili i ka përshkruar të gjitha veprimet e ndërrmar në këtë çështje civile, fillimisht ka njoftuar se pala ankuese A.Ll fare nuk përcaktohet palë në këtë çështje siç vërtetohet në faqen 8 të parashtrësës së të autorizuarit të propozuesve av.B.T të dt.10.03.2023. Pas kthimit të lëndës CN.nr.77/22 nga Gjykata e Apelit të Kosovës të njejtën e ka pranuar me dt.22.06.2022, ndërsa me dt.15.09.2002 ka mbajtur seancën e parë konform rekomandimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit. Seanca e radhës është caktuar me dt.17.10.2023, kjo senacë është shtyer me kërkesën e kundërpözuese Komuna e Vushtrrisë. Eksperti gjeodet S.G me parashtrësën e dt.15.11.2022 e ka njoftuar Gjykatën se për shkaqe shëndetësore nuk mund ti përmbush detyrat e dhëna sipas Aktvendimit të dt.15.09.2022. Gjykata me dt.13.03.2023 e ka mbajtur seancën e radhës në të cilën është vendosur që sërish të ftohet eksperti gjeodet S.G për ta kryer ekspertizën në të kundërtën Gjykata do të caktoj ekspertin tjetër. Me dt.15.09.2023 Eksperti Gjeodet S.G ka pranuar shkresat e lëndës për të përpiluar ekspertizën. Pas pranimit të Ekspertizës të dt.06.10.2023 Gjykata me aktvendimin e dt.31.10.2023 i ka obliguar propozuesit që në afat prej 3 ditësh të

pagujë ekspertin shpenzimet për përpilimin e ekspertizës. Me dt.08.11.2023 Gjykata ka pranuar njoftimin e propozuesve lidhur me pagesën e shpenzimeve për ekspertizë. Gjykata menjëherë pas pranimit të njoftimit për pagesën e shpenzimeve për ekspertizë ka caktuar seancën e radhës për dt.22.11.2023 në ora 10:00 min., ashtu që krejt në fund deklaroj me përgjegjësi të plotë se Lëndën CN.nr.77/22 është procedura në kuadër të gjitha mundësive duke marrë parasysh edhe ngarkesën e madhe me lëndë dhe nuk ka pasur asnjë pretendim për zvarritjen e procedurës siç pretendon personi A.L.

Pas shqyrtimit të kërkesës së palës ankuese, kërkesa si e tillë është konsideruar e pabazuar për faktin se Gjyqtari i çështjes, në deklaratën e dhënë ka përshtuar të gjitha veprimet e ndërmarra me qëllim të përfundimit të Lëndës CN.nr.77/22 dhe pretendimet të cilat i ka ngritur pala ankuese për autoritetin kompetent nuk mund të qëndroj konkretisht nuk mund t'i m'vishet gjyqtarit të çështjes fakti i mos përfundimit të lëndës për arsye se i njëjti ashtu siç ka theksuar në deklaratën e tij ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për përfundimin e lëndës duke i bashkangjitur edhe dëshmitë të cilat i ka theksuar në deklaratën e tij. Është fakt që rezulton si lëndë e vjetër mirëpo gjyqtari i çështjes me Lëndën CN.nr.77/22 është ngarkuar me lëndën me dt.22.06.2022 dhe janë ndërmarrë veprime në këtë rast në shqyrtim të çështjes siç konstatohet nga provat e bashkangjitura nga gjyqtari edhe përkundër se gjyqtari i çështjes është ngarkuar edhe me një numër të madh të lëndëve të tjera të cilat kanë prioritet ligjor për shkak se Dega e Gjykatës në Vushtrri ka trashëguar një numër të madh të lëndëve të natyrës civile, ku gjyqtarët edhe përkundër ngarkesës janë duke dhënë angazhimin maksimal për përmirësimin e gjendjes, në zvogëlimin e numërit të lëndëve i cili fakt është duke ndodhur, gjyqtari në rastin konkret është në procedim të çështjes siç ka theksuar edhe në përgjigjen e dhënë nga gjyqtari duke siguruar ekspertizën nga ana e ekspertëve të fushës përkatëse dhe me dt.22.11.2023 ka qenë e caktuar vazhdimi i seancës gjyqësore në këtë çështje.

Andaj autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është e pabazuar, pretendimet për shkeljet konkret të Ligjit për Përgjegjësi disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror janë të pa qëndrueshme, nuk kemi asnjë dyshimi të qëndrueshëm për veprimet të mëtejshme procedurale në raport me subjektin e hetimit duke marrë për bazë përgjigjen e marrë nga gjyqtari i çështjes dhe provat që i njëjti i ka ofruar autoritetit kompetent, të cilat në mënyrë të qartë tregojnë për veprimet e ndërmarra lidhur me Lëndën CN.nr.77/22, se i njëjti ka ndërmarrë veprimet konkrete procedurale për përfundimin e çështjes është caktuar vazhdimi i seancës gjyqësore për dt.22.11.2023 dhe bazuar në këto nuk mund të konsiderohet se kemi shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit të çështjes lidhur me zvarritje të procedurës.

Nga arsyet e theksuara më lart, në mbështetje të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
AD.GJTHM.nr.11/2023, dt.23.11.2023

U.D Kryetari i Gjykatës
Bekim Veliqi

Aktvendimi i dërgohet;
Këshillit Gjyqësor të Kosovës
Parashtruesit A.LI
Gjyqtarit J.Z